

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-242/2015

**Prishtinë,
3 Maj 2018**

Në çështjen juridike të:

M. Sh.

Pala ankuese

Kundër

B.D.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/240/2014 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA17623) të datës 30 Prill 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 3 Maj 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga M. Sh. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës Nr. KPCC/D/C/240/2014, të datës 30 Prill 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA17623.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/240/2014 i datës 30 Prill 2014, sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA17623.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 1 dhjetor 2006 B. D. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë), ka paraqitur një kërkesë me të cilën kërkon vërtetimin e të drejtës pronësore ndaj lokalit afarist i ndërtuar në ngastrën Nr.1355/9, me sipërfaqe prej 23 m² që ndodhet në rrugën “Miladin Popovic” në Rahovec, Komuna e Rahovecit (më tutje :prona e kërkuar). Ai deklaroi se prona ishte uzurpuar dhe se e ka humbur posedimin për shkak të konfliktit të armatosur të viteve 1998/99, duke diktuar 12 qershorin 1999 si datën e humbjes.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala përgjegjëse në ankesë i dorëzoi në AKP këto dokumente:
 - Fletën Poseduese Nr.2630 të lëshuar nga Drejtoria e Gjeodezisë në Komunën e Rahovecit më 13 prill 1984
 - Vendimin Nr. 463-47, të lëshuar nga Dhoma e Bashkësive Lokale të Kuvendit Komunal të Rahovecit më 28 tetor 1983 ku miratohet kërkesa e M. D. për t’ia ndarë në shfrytëzim të përhershëm ngastrën kadastrale nr.1355/9 me sipërfaqe prej 4.81 ha
 - Kopjen e planit të lëshuar nga Zyra Komunale për Gjeodezi, Komuna Kadastrale e Rahovecit më 13 prill 2004;
 - Kontratën mbi ndarjen e bashkësisë familjare të M. D.(ndarësi) ndërmjet djemve të tij B., Z. dhe N. D, e lidhur më 01 qershor 1986 dhe e vërtetuar nga Gjykata Komunale e Rahovecit më 20 qershor 1986.
 - Autorizim i dhënë nga vëllai i palës përgjegjëse në ankesë N. D. për ta poseduar pronën. Autorizimi ishte i vërtetuar në Gjykatën e pestë Komunale në Beograd me numër Ov.Br.10311/08, data 28 Mars 2008;
 - Aktvendimin i trashëgimisë O.br.25/2008 i lëshuar më 14 prill 2008 nga Gjykata Komunale e Rahovecit. Sipas aktvendimit të trashëgimisë, pala përgjegjëse në ankesë dhe vëllezërit e tij i kanë trashëguar pronat nga babai i tyre i ndjerë, përfshirë

- ngastrën nr.1355/9, ku secili prej tyre merr një pjesë ideale të 1/3 të pronave të kërkuara;
- Aktvendim Nr. 369 i lëshuar me datën 10 qershor 2008 nga Drejtoria për Kadaster në Rahovec me të cilin lejohej bartja e pronësisë për ngastrën 1355/9 me numër protokoli 369 datë 10 Qershor 2008;
3. Dokumentet e lartcekura janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së me përjashtim të vendimit Nr. 463-47. Ky vendim nuk është gjetur në arkivin e Komunës së Rahovecit.
 4. Kërkesa është kontestuar nga M. Sh. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) i cili pretendon se ka të drejtë ligjore mbi pronën e kërkuar. Pala ankuese deklaroi se kjo pronë ka qenë e gjyshit të tij por ishte shpronësuar në vitin 1954. Më 3 gusht 2010 ai nënshkroi njoftimin e pjesëmarrjes.
 5. Për t'i mbështetur pretendimet e veta, pala ankuese dorëzoi *inter alia*:
 - Vendimin nr.463-47, të lëshuar nga Këshilli i Bashkësive Lokale të Kuvendit Komunal të Rahovecit më 28 tetor 1983;
 - Vendimin nr.10-133/84 të datës 2 tetor 1984 të lëshuar nga Departamenti për pronë dhe punë juridike të Kuvendit Komunal të Rahovecit mbi urdhërimin e M. D.(babait të palës përgjegjëse në ankesë) që urgjentisht t'i tërheq kufijtë e caktuar në ngastrën nr.1355/9 ;
 - Procesverbalin e hartuar gjatë takimit të Departamentit për Pronë dhe Punë Juridike të Kuvendit Komunal të Rahovecit.
 6. Dokumentet e lartcekura janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive me përjashtim të vendimit nr. 463-47.Ky vendim nuk është gjetur në arkivin e Komunës së Rahovecit.
 7. Identifikimi fizik i pronës fillimisht është bërë më 7 mars 2007. Sipas raportit të identifikimit prona rezultoi të jetë restorant i uzurpuar nga V. dhe B.B. të kanë deklaruar se nuk pretendojnë të drejt ligjore mbi pronën e kërkuar.
 8. Me vendimin KPCC/D/R/213/2012 të datës 21 Gusht 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK-ja) vendosi ta aprovojë kërkesën e B.D. Sipas vendimit, B. D. është pronar i 1/3 të pronës së kërkuar dhe ka të drejtën e posedimit të pronës në fjalë.
 9. Vendimi i KKPK-së iu dorëzua palës ankuese më 15 Janar 2015, ndërsa ai paraqiti ankesë më 6 Shkurt 2015.
 10. Ankesa iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë më 7 Tetor 2015.

Pretendimet e palës ankuese

11. M. Sh, pretendon se ai e ka të drejtën pronësore mbi ngastrën 1355/9 dhe për këtë arsye ai ka dorëzuar një kërkesë Nr.294/2011 para Gjykatës Komunale të Rahovecit. Ai deklaroi se Komuna e Rahovecit ia ka dhënë babait të palës përgjegjëse në ankesë të drejtën e

shfrytëzimit të përhershëm të pronës, sipas vendimit Nr.463-47 dhe se babai i tij e ka keqpërdorur këtë të drejtë duke e uzurpuar pronën shoqërore që kufizohet me pronën e kërkuar. Pala ankuese më tej thekson se pronari i vërtetë i kësaj prone është Komuna e Rahovecit.

Pretendimet e palës përgjegjëse në ankesë

12. B. D, në përgjigje ndaj ankesës së palës ankuese, deklaroi se prona e kërkuar ka qenë nën pronësinë e babait të tij sipas vendimit Nr.463-47 dhe Fletës Poseduese Nr.2630.
13. Pala përgjegjëse në ankesë e ka fituar të drejtën e bashkë-pronësisë në bazë të Aktvendimit të Trashëgimisë e që tregon se e drejta pronësore mbi pronën është bartur nga babai i palës përgjegjëse në ankesë te ai dhe vëllezërit e tij.
14. Lidhur me pretendimet e palës ankuese se babai i palës përgjegjëse në ankesë ka uzurpuar pjesë të ngastrës tjetër, ai qartëson se vendimi i KKKPK-së ka konfirmuar të drejtën pronësore mbi ngastrën e kërkuar, jo mbi ngastrën tjetër. Për këto arsye, ai kërkon që Gjykata Supreme ta refuzojë ankesën e M. Sh. si të pabazuar.

Arsyetimi ligjor

Meritat

15. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve, Gjykata Supreme nuk ka gjetur as gabim thelbësor e as zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale, apo vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të fakteve.
16. Fleta Poseduese Nr.2630 tregon se babai i palës përgjegjëse në ankesë ishte njohur dhe regjistruar si pronar legjitim i pronës së kërkuar. Për më tepër, bartja e së drejtës pronësore është bërë si duhet në përputhje me Aktvendimin e Trashëgimisë, i cili është verifikuar pozitivisht. Gjykata Supreme konstaton se faktet e vërtetuara dhe provat e dorëzuara nga pala përgjegjëse në ankesë tregojnë se ai është pronar i ligjshëm i pronës së kërkuar.
17. Pretendimi i palës ankuese se gjyshi i tij ishte pronar i tokës, e cila është shpronësuar në vitin 1954 nuk ndikon në vendimin e KKKPK-së. Pala Ankuese nuk ka arritur që të paraqet fakte juridikisht të vlefshme për të dëshmuar se vendimi i KKKPK-së është i pabazuar. Në paragrafët 25-28 të Vendimit të KKKPK-së thuhet se pala përgjegjëse ka dëshmuar bashkëpronësi mbi pronën e kërkuar kurse urdhëri i KKKPK-së konfirmon pronësinë dhe nuk e kthen posedimin për arsye se prona shfrytëzohej si restorant me pëlqimin e palës përgjegjëse në ankesë.
18. Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga pala ankuese, pretendimet e cekura në ankesë dhe provat e paraqitura nga ai, rezultoi se vendimi i ankimuar ishte lëshuar pas një vërtetimi të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të saktë të së drejtës materiale dhe procedurale. Pala ankuese nuk ka arritur që të

paraqesë fakte të vlefshme juridikisht apo prova të vlefshme për të dëshmuar se vendimi i KKKPK-së është i pabazuar.

19. Gjykata Supreme konstaton se KKKPK-ja ka marrë vendim të drejtë, të bazuar në procedurë të plotë dhe korrekte. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim të mangët të fakteve. Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar dhe prandaj duhet të vërtetohet Vendimi i ankimuar.
20. Në bazë të lartcekurave dhe sipas dispozitave të nenit 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenit 195, paragrafi d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky Aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtare e EULEX-it

Ragip Namani, Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, Referente e EULEX-it